



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

**“NDËRTIM”**

**B-II-25**

**Niveli i II në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit II të KEK<sup>2</sup>**

**Tiranë 2025**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Europiane e Kualifikimeve

## **Përmbajtja**

Emërtimi i kualifikimit .....	4
Kodi .....	4
Kohëzgjatja .....	4
Niveli .....	4
Qëllimi: .....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit: .....	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit: .....	4
Ofruesit .....	4
Data e validimit .....	4
Data e miratimit .....	4
Variantet e mëparshme .....	4
<b>STRUKTURA E KUALIFIKIMIT .....</b>	<b>5</b>
<b>KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>5</b>
<b>NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL: .....</b>	<b>5</b>
Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehi profesionale).....	5
<b>NjN-02-II-0225-25 Bazat e vizatimit teknik .....</b>	<b>5</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	5
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	6
Kriteret e vlerësimit .....	6
<b>NjN-02-II-0226-25 Materialet bazë në ndërtim.....</b>	<b>6</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	7
Kriteret e vlerësimit .....	7
<b>NjN-02-II-0227-25 Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në ndërtim .....</b>	<b>7</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesional .....	8
Kriteret e vlerësimit .....	8
<b>NjN-02-II-0228-25 Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi .....</b>	<b>9</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	9
Kriteret e vlerësimit .....	9
<b>NjN-02-II-0229-25 Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime .....</b>	<b>10</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	10
Kriteret e vlerësimit .....	10
<b>NjN-02-II-0230-25 Punime ndihmëse në nënshtrësa, shtrësa niveluese dhe izoluese</b>	<b>10</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	11
Kriteret e vlerësimit .....	11
<b>NjN-02-II-0231-25 Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje .....</b>	<b>11</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	12
Kriteret e vlerësimit .....	12
<b>NjN-02-II-0232-25 Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka .....</b>	<b>12</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	12

Kriteret e vlerësimit .....	12
<b>NjN-02-II-0233-25 Punime ndihmëse në veshje fasadash .....</b>	<b>13</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	13
Kriteret e vlerësimit .....	13
<b>NjN-02-II-0234-25 Punime ndihmëse në ndërtim çatie dhe tarrace .....</b>	<b>13</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	13
Kriteret e vlerësimit .....	14
<b>NjN-02-II-0235-25 Punime ndihmëse në ndërtim rrugësh .....</b>	<b>14</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	14
Kriteret e vlerësimit .....	14
<b>NjN-02-II-0236-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ndërtim .....</b>	<b>15</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	15
Kriteret e vlerësimit .....	16
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:.....	16
Modalitetet e vlerësimit .....	17
<b>SHËNIM .....</b>	<b>17</b>

Emërtimi i kualifikimit	NDËRTIM			Kodi B-II-25
Kohëzgjatja	3000 orë nocionale	Niveli	Niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Ndërtim”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar, si ndihmës, në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e ndërtimit.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Ndërtim” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;</li> <li>– janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;</li> <li>– pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Ndërtim”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, pajis individin me Certifikatën e Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli, si punëtor gjysmë i kualifikuar në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar si ndihmës në sipërmarrje të ndryshme ndërtimi ose sipërmarrje të tjera që kryejnë veprimtari në fushën e ndërtimit, si edhe në pika të shërbimeve teknike</p> <p>Për sa i përket arsimimit të mëtejshëm, individi ka mundësi të vazhdojë studimet në kualifikime të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, në Ndërtim”.</p> <p>Me vijimin e mëtejshëm të arsimit profesional në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Ofruesit</b>	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
<b>Data e validimit</b>	<i>Korrik 2025</i>			
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	<b>B-I-16, B-II-20</b>			

## **STRUKTURA E KUALIFIKIMIT**

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ndërtim” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

### **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

*Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.*

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
8. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
10. Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:**

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

#### **NjN-02-II-0225-25 Bazat e vizatimit teknik**

##### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të lexojë shenjat dalluese të paraqitjes së strukturave të ndërtimit;
2. Të lexojë simbolet e hartave të thjeshta;
3. Të përshkruajë shkallët e vizatimit të paraqitjes së trupave në vizatimin teknik;
4. Të lexojë vizatime dhe skica detajesh, me përmasa të ndryshme;
5. Të lexojë vizatime të planimetrisë, pamjes, prerjes dhe detajet e tyre për një ndërtesë

të thjeshtë;

6. Të lexojë vizatime dhe skica detajesh hekurkthimi, për një ndërtesë të thjeshtë;
7. Të lexojë vizatime dhe skica detajesh të mureve për një ndërtesë të thjeshtë;
8. Të lexojë vizatime dhe skica detajesh të shtresave dhe nënshtresa për një ndërtesë të thjeshtë;
9. Të lexojë vizatime të ndryshme të shenjave të pajisjeve hidrosanitare;
10. Të lexojë vizatime të ndryshme të shenjave të pajisjeve elektroshtëpiake;
11. Të lexojë shenjat dalluese të sinjalistikës rrugore.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

12. Të vizatojë shenjat dalluese të strukturave të ndërtimit dhe simbolet në harta;
13. Të përdorë shkallët e vizatimit të paraqitjes së trupave sipas skicës së dhënë në vizatimin teknik;
14. Të vizatojë skica detajesh të ndryshme duke përdorur shkallët e vizatimit, sipas përmasave të dhëna;
15. Të vizatojë planimetri, pamje, prerje dhe detajet e tyre për një ndërtesë të thjeshtë;
16. Të vizatojë detaje hekurkthimi, për një ndërtesë të thjeshtë;
17. Të vizatojë detaje të mureve, shtresave dhe nënshtresave për një ndërtesë të thjeshtë;
18. Të vizatojë shenjat e pajisjeve hidrosanitare dhe të pajisjeve shtëpiake për një ndërtesë të thjeshtë;
19. Të vizatojë shenjat dalluese të sinjalistikës rrugore.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Vizaton shenjat dalluese të strukturave të ndërtimit, sipas skicës;
- Vizaton simbolet e hartave të thjeshta që përdoren në vizatimet e ndërtimit, sipas skicës;
- Zbaton shkallët e vizatimit të paraqitjes së trupave sipas skicës së dhënë në vizatimin teknik;
- Vizaton skica, me përmasa të ndryshme sipas shkallës së vizatimit për një ndërtesë të thjeshtë;
- Vizaton planimetri, pamje, prerje dhe detajet e tyre për një ndërtesë të thjeshtë;
- Vizaton detaje hekurkthimi, sipas skicës së dhënë për një ndërtesë të thjeshtë;
- Vizaton detaje të mureve sipas skicës së dhënë, për një ndërtesë të thjeshtë;
- Vizaton detaje të shtresave dhe nënshtresave, sipas skicës së dhënë për një ndërtesë të thjeshtë;
- Vizaton shenjat e pajisjeve hidrosanitare sipas skicës së dhënë për një ndërtesë të thjeshtë;
- Vizaton shenjat e pajisjeve elektroshtëpiake, sipas skicës së dhënë;
- Vizaton shenjat dalluese të sinjalistikës rrugore, sipas skicës së dhënë.

### **NjN-02-II-0226-25 Materialet bazë në ndërtim**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

20. Të rendisë vetitë kryesore të materialeve të ndërtimit;
21. Të listojë materialet e ndërtimit sipas fushës së përdorimit të tyre;

22. Të përshkruajë materialet lidhëse joorganike dhe organike që përdoren në ndërtim;
23. Të rendisë materialet metalike dhe të kombinuara që përdoren në ndërtim;
24. Të shpjegojë llojet dhe markat e betoneve dhe llaçeve;
25. Të përshkruajë llojet e përbërësve të betonit dhe llaçeve, si dhe përdorimet e tyre;
26. Të përshkruajë llojet e përbërësve për përgatitjen e bojrave;
27. Të listojë materialet që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës të një objekti ndërtimi;
28. Të listojë materialet për ndërtimin e mureve;
29. Të listojë pllakat e përdorura për shtrim dhe veshje;
30. Të listojë materialet për punimet e gipsit;
31. Të listojë materialet që përdoren në shtresat rrugore;
32. Të listojë materialet izoluese.

### **Rezultatet e të nxënimit në shprehi profesionale**

33. Të dallojë vetitë kryesore të materialeve të ndërtimit;
34. Të dallojë materialet e ndërtimit sipas llojit dhe fushës së përdorimit të tyre;
35. Të dallojë materialet lidhëse joorganike dhe organike që përdoren në ndërtim;
36. Të dallojë materialet metalike dhe të kombinuara që përdoren në ndërtim;
37. Të përzgjedhë materialet përbërëse të betonit sipas markës së dhënë;
38. Të përzgjedhë materialet përbërëse të llaçeve sipas raportit të dhënë;
39. Të dallojë materialet e patinimit, bojatisjes, pigmentet, tretësit dhe lëndët lidhëse, sipas përdorimit;
40. Të dallojë materialet që përdoren për punimet në ndërtim.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Dallon materialet e ndërtimit, sipas llojit dhe përdorimit të tyre;
- Dallon materialet lidhëse joorganike dhe organike që përdoren në ndërtim, sipas llojit;
- Dallon materialet metalike dhe të kombinuara që përdoren në ndërtim, sipas llojit;
- Zbaton recepturat e materialeve përbërëse të betonit sipas markës së dhënë;
- Zbaton recepturat e materialeve përbërëse të llaçeve sipas raportit të dhënë;
- Dallon materialet e patinimit, bojatisjes, pigmentet, tretësit dhe lëndët lidhëse sipas përdorimit;
- Dallon materialet që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës të një objekti të thjeshtë ndërtimi, sipas përdorimit;
- Dallon llojet e materialeve për ndërtimin e mureve sipas përdorimit;
- Dallon llojet e pllakave të përdorura për shtrim dhe veshje sipas përdorimit;
- Dallon llojet e materialeve për punimet e gipsit, sipas përdorimit;
- Dallon llojet e materialeve që përdoren në shtresat rrugore;
- Dallon llojet e materialeve izoluese, sipas përdorimit.

### **NjN-02-II-0227-25 Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në ndërtim**

### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

41. Të përshkruajë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të një kantieri ndërtimi;
42. Të rendisë radhën e punës për detyrën e dhënë;
43. Të listojë veglat dhe materialet e punës sipas përdorimit të tyre;
44. Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së veglave dhe materialeve të punës;
45. Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit para përdorimit të mjeteve të punës;
46. Të përshkruajë mënyrën e transportimit të materialeve të ndërtimit sipas grafikut të punimeve;
47. Të përshkruajë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
48. Të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë;
49. Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes, pastrimit, sistemimit të veglave dhe vendit të punës;
50. Të shpjegojë rëndësinë e raportimit tek eprori;
51. Të shpjegojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me kolegët dhe eprorët
52. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
53. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera;
54. Të identifikojë nevojat për trajnim, metodat e zhvillimit profesional duke ndjekur trajnimet për teknologji të reja.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesional**

55. Të kryejë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike
56. Të kryejë përzgjedhjen, transportin dhe kontrollin e veglave dhe materialeve të punës para përdorimit;
57. Të kryejë mirëmbajtjen, pastrimin, sistemimin e veglave dhe vendit të punës;
58. Të kryejë raportimin tek eprori për detyrën e dhënë;
59. Të zbatojë parimet e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë;
60. Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me kolegët dhe eprorët;
61. Të përdorë korrekt terminologjinë profesionale;
62. Të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Merr detyrën e dhënë nga eprori;
- Zbaton radhën e punës për detyrën e dhënë;
- Përcakton veglat dhe materialet e punës sipas detyrës së dhënë;
- Kontrollon mjetet e punës, para përdorimit të tyre;
- Kryen transportin e materialeve të ndërtimit në objekt, sipas punimeve;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Bashkëpunon në grup me kolegë/specialistë të tjerë;
- Kryen mirëmbajtjen, pastrimin dhe sistemimin e veglave/materialeve dhe vendit të

- punës, sipas procedurës;
- Raporton tek eprori, sipas rregullores;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me kolegët dhe eprorët;
- Zbaton terminologjinë profesionale;
- Komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera;
- Kryen trajnime, sipas nevojave profesionale për teknologji të reja.

## **NjN-02-II-0228-25 Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi**

### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të listojë elementet konstruktiv beton-arme (pllakë/trarë të kryqëzuar/plinta, shtylla, mure, pllakat e trarëve të ndërkatit dhe shkallëve) në objektin ndërtimor;
2. Të listojë llojet e kallëpeve;
3. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së kallëpeve dhe përforcimit të tyre;
4. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit të armaturës së hekurit;
5. Të përshkruajë trajtimin e sipërfaqes së kallëpit;
6. Të përshkruajë mënyrën e lidhjes së armaturës së hekurit;
7. Të përshkruajë radhën e montim/çmontimit të skelerisë në lartësi;
8. Të përshkruajë përgatitjen e betonit;
9. Të shpjegojë rëndësinë e ngjeshjes së betonit;
10. Të përshkruajë hapat për trajtimin pas betonimit të strukturave prej betoni të armuar;
11. Të përshkruajë hapat dhe radhën e heqjes së kallëpeve, pastrimit dhe sistemimit të tyre.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të ndihmojë në përgatitjen e kallëpeve dhe përforcimin e tyre;
2. Të kryejë pastrimin dhe trajtimin e armaturës së hekurit;
3. Të ndihmojë në lidhjen e armaturës së hekurit;
4. Të ndihmojë në procesin e montim/çmontimit të skelerisë në lartësi;
5. Të përgatisë betonin sipas markës së dhënë;
6. Të kryejë hedhjen, ngjeshjen dhe trajtimin e betonit duke zbatuar afatin kohor;
7. Të ndihmojë në heqjen e kallëpeve, pastrimin dhe sistemimin e tyre.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Dallon llojet e kallëpeve, sipas materialit;
- Ndhmon në përgatitjen e kallëpeve dhe përforcimit të tyre, sipas udhëzimit;
- Kryen pastrimin e armaturës së hekurit, sipas teknikës;
- Kryen trajtimin e sipërfaqeve të armaturës, sipas teknikës;
- Ndhmon në lidhjen e armaturës së hekurit, sipas skicës;

- Ndhmon në montim/çmontimin e skelerisë në lartësi, sipas radhës së punës;
- Përgatit betonin, hedhjen dhe ngjeshjen e tij, sipas udhëzimit;
- Kryen trajtimin pas betonimit të strukturave prej betoni të armuar sipas udhëzimit;
- Ndhmon në heqjen e kallëpeve, pastrimin dhe sistemimin e tyre sipas radhës.

### **NjN-02-II-0229-25 Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të listojë llojet e llaçeve;
2. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së llaçeve;
3. Të listojë llojet e instrumenteve matëse dhe niveluese për ndërtimin e mureve dhe realizimit të procesit të suvatimeve;
4. Të shpjegojë llojet e tullave dhe përdorimin e tyre;
5. Të përshkruajë hapat për ndërtimin e mureve masive me tulla të llojeve të ndryshme;
6. Të përshkruajë hapat në ndërtimin e themelit dhe xokolit prej guri natyror;
7. Të përshkruajë hapat në ndërtimin e brezit, qemerit dhe të shtyllave kundër sizmike prej guri natyror e betoni;
8. Të përshkruajë hapat në ndërtimin e mureve mbushëse e të përzier;
9. Të përshkruajë hapat për përgatitjen e sipërfaqeve për suvatim;
10. Të përshkruajë hapat e proceseve të shtresave të suvatimit.

#### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të përgatisë lloje të ndryshme të llaçeve;
2. Të kryejë punime ndihmëse në ndërtimin e mureve;
3. Të kryejë punime ndihmëse në suvatim.

#### **Kriteret e vlerësimit**

- Përgatit llaçet sipas llojit dhe përdorimit të tyre;
- Ndhmon në ndërtimin e mureve masive me tulla të llojeve të ndryshme, sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në ndërtimin e themelit dhe xokolit prej guri natyror sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në ndërtimin e brezit, qemerit dhe të shtyllave kundër sizmike prej guri natyror e betoni sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në ndërtimin e mureve mbushëse e të përzier sipas udhëzimeve;
- Përgatit sipërfaqet për suvatim sipas udhëzimit;
- Ndhmon në realizimin e shtresave të suvatimit sipas udhëzimeve.

### **NjN-02-II-0230-25 Punime ndihmëse në nënshtresa, shtresa niveluese dhe izoluese**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së sipërfaqeve që do të izoloohen;
2. Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e ngjeshjes së tokës;

3. Të përshkruajë mënyrat e shpërndarjes me vegla dore të inerteve të nënshtresave;
4. Të përshkruajë rëndësinë e ngjeshjes së nënshtresave me vegla dore;
5. Të përshkruajë mënyrat e shpërndarjes së betonit në sipërfaqe;
6. Të përshkruajë rëndësinë e nivelimit të sipërfaqes;
7. Të përshkruajë radhën e punës së procesit të hidroizolimit, termoizolimit, izolimit akustik;
8. Të shpjegojë rëndësinë e paratrajtimit të sipërfaqeve;
9. Të përshkruajë mënyrat e riparimit të shtresave të dëmtuara.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kryejë ngjeshjen e tokës;
2. Të kryejë punime ndihmëse në proceset e betonimit dhe trajnimin e tij;
3. Të kryejë shpërndarjen dhe ngjeshjen e inerteve të nënshtresave;
4. Të kryejë punime ndihmëse në proceset e izolimit;
5. Të kryejë punime ndihmëse në riparimin e shtresave të dëmtuara.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Përgatit sipërfaqet që do të izoloohen sipas teknikës;
- Zbaton mënyrat e ngjeshjes së tokës sipas udhëzimeve;
- Kryen shpërndarjen dhe ngjeshjen e inerteve dhe nënshtresave me vegla dore sipas udhëzimeve;
- Shpërndan betonin në sipërfaqe, sipas udhëzimeve;
- Ngjesh betonin, sipas udhëzimeve;
- Trajton betonimin, sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në nivelimin e sipërfaqes sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në proceset e izolimit sipas udhëzimeve;
- Paratrajton sipërfaqet sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në riparimin e shtresave të dëmtuara, sipas udhëzimeve.

### **NjN-02-II-0231-25 Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të përshkruajë radhën e punimeve me materiale gipsi, patinimeve dhe lyerjeve;
2. Të përshkruajë llojet e profileve të strukturës metalike dhe pllakave të gipseve;
3. Të përshkruajë radhën e vendosjes së profileve të strukturës metalike;
4. Të përshkruajë hapat e prerjes së pllakave të gipsit;
5. Të përshkruajë hapat e mbërthimit të pllakave të gipsit;
6. Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes së rrjetave në pikat e bashkimit të pllakave të gipsit;
7. Të përshkruajë përgatitjen e stukos për patinim;
8. Të përshkruajë hapat e lyerjes me astar të gatshëm të sipërfaqes;
9. Të përshkruajë mënyrat e smerilimit të sipërfaqes së patinuar;

10. Të përshkruajë mënyrat e patinimit të sipërfaqeve;
11. Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së bojërave;
12. Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes së materialeve mbrojtëse në sipërfaqet që nuk do të lyhen;
13. Të përshkruajë mënyrat e bojatisjes së sipërfaqeve.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kryejë punime ndihmëse në proceset e punimeve të gipsit;
2. Të kryejë punime ndihmëse në proceset e patinimit;
3. Të kryejë punime ndihmëse në proceset e lyerjes.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Ndhmon në vendosjen e profileve të strukturës metalike sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në prerjen e pllakave të gipsit sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në mbërthimin e pllakave të gipsit sipas udhëzimeve;
- Vendos rrjetat në pikat e bashkimit të pllakave të gipsit sipas udhëzimeve;
- Përgatit stukon për patinim sipas udhëzimit të paketimit;
- Lyen me astar të gatshëm sipërfaqen para bojatisjes, sipas udhëzimeve;
- Smerilon sipërfaqen e patinuar duke ndjekur teknikat udhëzuese;
- Ndhmon në patinimin e sipërfaqeve sipas mënyrave përkatëse;
- Ndhmon në përgatitjen e bojërave sipas llojit;
- Vendos materialet mbrojtëse në sipërfaqet që nuk do të lyhen, sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në bojatisjen e sipërfaqeve sipas udhëzimeve.

### **NjN-02-II-0232-25 Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të përshkruajë rëndësinë e përgatitjes së sipërfaqeve para shtrimit dhe veshjes me pllaka;
2. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së materialeve ngjitëse;
3. Të përshkruajë hapat e punës në procesin e shtrimit dhe veshjes me pllaka;
4. Të përshkruajë mënyrat e heqjes së kryqeve dhe pastrimit të fugave për hedhjen e bojakut;
5. Të përshkruajë rëndësinë e përgatitjes, përhapjes dhe pastrimit nga bojaku i tepërt në sipërfaqen e shtruar/veshur me pllaka.

#### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kryejë proceset e përgatitjes së sipërfaqeve para shtrimit dhe veshjes me pllaka;
2. Të kryejë punime ndihmëse në proceset e shtrimit dhe veshjes me pllaka.

#### **Kriteret e vlerësimit**

- Përgatit sipërfaqet para shtrimit dhe veshjes me pllaka sipas udhëzimeve;
- Përgatit materialet ngjitëse duke zbatuar afatin kohor;

- Ndhmon në procesin e shtrimit dhe veshjes me pllaka sipas udhëzimeve;
- Heq kryqet dhe pastron fugat për hedhjen e bojakut duke zbatuar afatin kohor;
- Kryen përhapjen dhe pastrimin nga bojaku i tepërt në sipërfaqen e shtruar/veshur me pllaka duke zbatuar afatin kohor.

### **NjN-02-II-0233-25 Punime ndihmëse në veshje fasadash**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të listojë llojet e veshjes së fasadës sipas përdorimit të tyre;
2. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së sipërfaqes së fasadës;
3. Të përshkruajë radhën e punës për veshje fasadash;
4. Të përshkruajë rëndësinë e trajtimit të materialeve të veshjes që mbeten të papërdorura.

#### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të përgatisë sipërfaqen e fasadës që do të vishet;
2. Të kryejë punime ndihmëse në proceset e veshjes së fasadave.

#### **Kriteret e vlerësimit**

- Përgatit sipërfaqen e fasadës që do të vishet sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në prerjen e materialeve për veshje sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në veshjen e fasadës sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në sistemimin/ruajtjen e materialeve të papërdorura në veshje fasadash sipas udhëzimeve.

### **NjN-02-II-0234-25 Punime ndihmëse në ndërtim çatie dhe tarrace**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të listojë llojet e çative dhe tarracave;
2. Të listojë llojet e elementeve të çative dhe tarracave;
3. Të përshkruajë mënyrën e përpunimit të elementeve të strukturës së çatisë;
4. Të shpjegojë mënyrat e lyerjes së elementëve të strukturës së çatisë;
5. Të klasifikojë llojet e aksesorëve të mbërthimit në nyjet e elementeve të strukturës së çatisë;
6. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së sipërfaqes së tarracës;
7. Të përshkruajë mënyrat e paratrajtimit të tarracës;
8. Të rendisë radhën e punës për shtrimin e materialit për izolim të tarracës;
9. Të listojë llojet e ulluqeve;
10. Të përshkruajë mënyrat e vendosjes së ulluqeve.

#### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kryej procesin e sharrimit të elementëve e nënshtresës së çatisë;
2. Të kryejë punime ndihmëse në procesin e ndërtimit të çatisë;

3. Të kryejë punime ndihmëse në vendosjen e ulluqeve;
4. Të kryejë punime ndihmëse në ndërtimin e shtresave izoluese të tarracës.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Sharron me vegla dore elementët e nënshtresës së çatisë me përmasat e dhëna sipas udhëzimeve;
- Pastron vendin e punës nga mbetjet e sharrimit para lyerjes sipas procedurës;
- Lyen me materialin e nevojshëm elementët e strukturës së çatisë sipas kushteve teknike;
- Ndhmon në mbërthimin e elementëve të çatisë sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në vendosjen e ulluqeve për mbledhjen dhe shkarkimin e ujërave të shiut sipas udhëzimeve;
- Përgatit sipërfaqen e tarracës sipas procedurave përkatëse;
- Ndhmon në shtrimin e materialit izolues të tarracës sipas udhëzimeve;
- Paratrajton tarracën sipas udhëzimeve.

### **NjN-02-II-0235-25 Punime ndihmëse në ndërtim rrugësh**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të listojë llojet e rrugëve;
2. Të listojë llojet e sinjalistikës provizore;
3. Të rendisë radhën e punës për shtrimin dhe ngjeshjen e shtresave të rrugës;
4. Të listojë llojet e sinjalistikave horizontale dhe vertikale në rrugë (vijëzimet tabelat, semaforët etj.);
5. Të përshkruajë llojet e elementëve të sigurisë rrugore;
6. Të shpjegojë mënyrat e lagies me ujë gjatë procesit të ngjeshjes me rul të shtresave të rrugës;
7. Të shpjegojë mënyrat e spërkatjes me emulsion bituminoz të sipërfaqes së rrugës;
8. Të listojë llojet e bordurave dhe mënyrat e vendosjes së tyre;
9. Të përshkruajë mënyrat e riparimit të shtresave asfaltike të dëmtuara.

#### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kryejë punime ndihmëse në piktimin e rrugës;
2. Të kryejë punime ndihmëse në procesin e ndërtimit të rrugëve;
3. Të kryejë punime ndihmëse në vendosjen e sinjalistikës;
4. Të kryejë punime ndihmëse në riparimet e shtresave rrugore të dëmtuara.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Ndhmon topografin në piktimin e rrugës sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në vendosjen e sinjalistikës provizore sipas udhëzimeve;
- Ndhmon specialistin në shtrimin e shtresave rrugore sipas udhëzimeve;
- Ndhmon gjatë ngjeshjes së shtresave rrugore, sipas udhëzimeve;

- Lag me ujë sipërfaqen e rrëluar të rrugës sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në spërkatjen me emulsion bituminoz të sipërfaqes së rrugës sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në vendosjen e bordurave kufizuese të rrugës dhe shtrimit të trotuareve sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, si dhe elementëve të sigurisë sipas udhëzimeve;
- Ndhmon në riparimet e shtresave rrugore të dëmtuara sipas udhëzimeve.

## **NjN-02-II-0236-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ndërtim**

### **Rezultatet e të nxënësve në njohuri**

1. Të listojë pajisjet mbrojtëse individuale (PMI) në punë;
2. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të procedurave për mbrojtjen e shëndetit dhe higjienës personale;
3. Të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të sinjalistikës në mjediset e punës;
5. Të përshkruajë procedurën e evakuimit në raste emergjence;
6. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të kutisë së ndihmës së shpejtë dhe MNZSH-s;
7. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme të kantierit;
8. Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së distancave të rekomanduara gjatë procesit të punës;
9. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të rregullave të punës në lartësi;
10. Të përshkruajë rëndësinë e rregullores përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
11. Të identifikojë ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
12. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
13. Të shpjegojë rëndësinë e raportimit të keqfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë në punë;
14. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm.

### **Rezultatet e të nxënësve në shprehje profesionale**

1. Të zbatojë standardet dhe rregullat e sigurimit teknik në punë;
2. Të përdorë pajisjet mbrojtëse individuale (PMI) në punë;
3. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit dhe higjienës personale;
4. Të zbatojë dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
5. Të zbatojë procedurën e evakuimit në raste emergjence;
6. Të përdorë kutinë e MNZSH-s;
7. Të zbatojë rregullat e punës në lartësi duke zbatuar rregulloren e brendshme të kantierit;
8. Të kryejë ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
9. Të respektojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
10. Të zbatojnë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

## Kriteret e vlerësimit

- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Respekton sinjalistikën në mjediset e punës sipas rregullores;
- Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
- Zbaton rregullat e ruajtjes së distancave të rekomanduara në vendin e punës sipas rregullores së sigurimit teknik;
- Zbaton rregullat e punimeve në lartësi sipas rregullores së sigurimit teknik;
- Përdor pajisjet mbrojtëse individuale(pmi) në punë sipas rregullores së sigurimit teknik;
- Zbaton rregullat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike sipas udhëzimeve për përdorim të prodhuesit;
- Raporton në kohë keqfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë në punë sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton ndarjen e mbetjeve sipas llojit në zbatim të rregullores për menaxhimin e mbetjeve të ngurta që dalin gjatë ndërtimit;
- Depoziton mbetjet nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Përdor në mënyrë racionale energjinë dhe materialet sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme sipas udhëzimeve teknike.

## Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Bazat e vizatimit teknik	9	NjN-02-II-0225-25
2	Materialet bazë në ndërtim	6	NjN-02-II-0226-25
3	Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në ndërtim	3	NjN-02-II-0227-25
4	Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi	12	NjN-02-II-0228-25
5	Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime	12	NjN-02-II-0229-25
6	Punime ndihmëse në nënshtresa, shtresa niveluese dhe izoluese	12	NjN-02-II-0230-25
7	Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje	12	NjN-02-II-0231-25
8	Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka	9	NjN-02-II-0232-25
9	Punime ndihmëse në veshje fasadash	9	NjN-02-II-0233-25
10	Punime ndihmëse në ndërtim çatie dhe tarrace	6	NjN-02-II-0234-25
11	Punime ndihmëse në ndërtim rrugësh	4	NjN-02-II-0235-25
12	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ndërtim	6	NjN-02-II-0236-25
	<b>Totali</b>	<b>100</b>	

## **Modalitetet e vlerësimit**

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN-së për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësisive të të nxënit. Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

## **Informacion shtesë**

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

## **SHËNIM**

*Shpjegime të kodit të kualifikimit: B-II-25*

**B** – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

**II** – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK-së

**25** – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

*Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: NjN-02-II-0225-25*

**NjN** – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

**02** – Numri që identifikon fushën e Njësive të të Nxënit

**II** – Shifra që tregon nivelin e Njësive të të Nxënit në strukturën e KSHK-së

**0225** – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

**25** – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit